

**V E N D I M**  
**Nr.131, datë 20.3.1995**

**PËR SHTYPJEN NGA BANKA E SHQIPËRISË TË BONOVE TË PRIVATIZIMIT**

Në bazë të dekretit të Presidentit të Republikës “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit” dhe me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

I. Vlera në total e bonove të privatizimit për procesin e plotë të privatizimit masiv sipas grup-moshave do të jetë:

Për shtetasit e moshës 18 deri në 35 vjeç 50.000 lekë privatizimi

Për shtetasit e moshës 36 deri në 55 vjeç 75.000 lekë privatizimi

Për shtetasit e moshës 56 vjeç e lart 100.000 lekë privatizimi

II. Banka e Shqipërisë të shtypë bonot e privatizimit për fazën e parë të privatizimit masiv sipas karakteristikave të mëposhtme:

1. Sasia

600.000 (copë) emetohen bono privatizimi me vlerë 10.000 lekë privatizimi

396.000 (copë) emetohen bono privatizimi me vlerë 15.000 lekë privatizimi

204.000 (copë) emetohen bono privatizimi me vlerë 20.000 lekë privatizimi

2. Përmasat

Për të tri klasifikimet e mësipërme përmasa e bonove të privatizimit është: 145x175.

3. Elementet e sigurisë së bonove të privatizimit

- Fill sigurie i dallueshëm kundrejt dritës dhe fluoreshent nën dritën ultraviolet.

- Watermark standard, i regjistruar, i shpërndarë në të gjithë sipërfaqen.

- Katër ngjyra shtyp offset, nga të cilat një ngjyrë fluoreshente e dallueshme në dritën e llampës UV, ana e pasme vetëm me një ngjyrë offset.

- Dy numeratorë fluoreshent, të dukshëm në dritën e llampës UV.

4. Karakteristika të letrës

- pesha: 82 g/m<sup>2</sup>

- përbërja: mbi 90% pambuk

5. Kompozimi i figurës

Figura e Skënderbeut në të tri prerjet e bonove të privatizimit të specifikuara sipas pikës 1.

Kompozimi i bonove të privatizimit të bëhet nga Banka e Shqipërisë.

6. Përmbajtja e bonos së privatizimit

a) Në anën e përparme do të shkruhen dhe vendosen:

- Republika e Shqipërisë

- Portreti i Skënderbeut

- Letër shtetërore me vlerë

- BONO PRIVATIZIMI

- Shuma \_\_\_\_\_ lekë privatizimi

- Afati i përdorimit deri më 30.6.1996

- Fabrikimi dhe shpërndarja e bonove të falsifikuara dënohet me ligj

- Numri i serisë \_\_\_\_\_

b) Në anën e pasme do të shkruhet:

- Kjo bono privatizimi është një letër shtetërore me vlerë, joemërore, lirisht e tregtueshme.

Bonot e privatizimit do të përdoren nga zotëruesi i tyre:

- për të hyrë si aksionar në shoqëritë tregtare që do të krijohen nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore dhe në shoqëritë investuese të letrave me vlerë;

- për të blerë elemente të veçanta të pasurisë së ndërmarrjeve shtetërore që do të privatizohen.

Bonot e privatizimit mund të tregtohen ndërmjet shtetasve.

- Bonot e privatizimit janë të vlefshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

- Humbja dhe dëmtimi i bonos së privatizimit nuk zëvendësohet me dublikatë.

- Bonot e privatizimit nuk janë të vlefshme pa vulë.

III. Kostoja e shtypit të bonove të privatizimit përballohet nga buxheti i shtetit.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**